



LUMENJTË UDHËHUMBUN

BEŠA KALAJA, KOSOVARE LALINOVCİ



Lumenjtë udhëhumbun

Mijëra hektarë të shtretërve të lumenjve janë degraduar nga eksploatuesit ilegalë që nga paslufta. Qeveria pati nxjerrë vendim për ndalimin e eksploatimit të rërës dhe zhavorrit por përpjekjet e saj për ta arritur këtë pothuajse në të gjitha rastet kanë dështuar. Edhe sot një numër i madh i kompanive vazhdon punën pa u penguar nga askush

BESA KALAJA, KOSOVARE LALINOVC

Industria e ndërtimit në Kosovën e pasluftës u zhvillua hovshëm por kjo shkoi në dëm të lumenjve, prej nga u nxor rërë e zhavorr pa kritere, në sy të institucioneve.

Eksploatuesit ilegalë sot e dominojnë tregun e rërës dhe zhavorrit. Këta operatorë që veprojnë pa leje nuk respektojnë asnjë kriter gjatë nxjerrjes së rërës dhe zhavorrit dhe në këtë mënyrë kanë degraduar mijëra hektarë të shtretërve të lumenjve si dhe kanë ndryshuar edhe rrjedhën natyrale të këtyre lumenjve.

Sipas Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) në periudhën 2009 - 2014 janë evidentuar 178 operues ilegalë të cilët kanë kryer 207 operime ilegale. Por ky është vetëm numri i atyre që i ka evidentuar KPM-ja, pasi që numri real i tyre është shumë më i madh.

Ndalja e operatorëve ilegalë që eksploatojnë rërë dhe zhavorr është shumë e vështirë për faktin se ka përzjerje të kompetencave ndërmjet institucioneve dhe ka numër të vogël të inspektorëve. Për me keq, Preportr ka gjetur se edhe këta inspektorë që aktualisht punojnë janë të lidhur me partitë politike, dhe janë zënë

duke u bërë favore kompanive të ndryshme ose u kanë kërkuar ryshfet atyre.

Institucionet shtetërore janë dorëzuar para eksploatuesve ilegalë. Drejtues të institucioneve dhe ish ministri i MMPH-së Dardan Gashi gjatë bisedës për Preportr e kanë pranuar se shteti në këto raste është treguar i pafuqishëm, duke u arsyetuar me faktin se operatorët ilegalë janë shumë të rrezikshëm dhe se kanë përdorur edhe armë kundër inspektorëve.

Një lajm i mirë që erdhi në fillim të vitit 2012 - se do t'u ndërpritet puna të gjithë eksploatuesve legalë dhe ilegalë - nuk solli efektin e dëshiruar.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për ndalim të kësaj veprimtarie në fillim u kundërshtua nga eksploatuesit, të cilët e dërguan rastin në gjykatë. Për vetëm disa ditë Gjykata Supreme mori vendim për pezullim të vendimit të qeverisë. Megjithatë qeveria bashkë me organizata e individë që merren me mbrojtjen e mjedisit u ankuan në këtë gjykatë, gjë që rezultoi me revokim të vendimit të mëparshëm.

Megjithëse dukej si një dritë në fund të tunelit, ky vendim nuk

u zbatua në tërësi. Në zbatim të këtij vendimi ishin angazhuar një mori institucionesh. Ishin thënë edhe fjalë të mëdha si ato që nëse makineritë nuk largohen do të ftohet KFOR-i për ndihmë, e madje edhe gjatë do të arrinin deri në 100 mijë euro.

Këto fjalë e angazhime nuk bënë shumë punë. Edhe gjatë kohës sa ai ishte në fuqi (vendimit i ka skaduar afati) kompanitë ilegale vazhduan të dëmtojnë lumenjtë, sidomos ata të Rrafshit të Dukagjinit. Disa pjesë të lumenjve janë të dëmtuara. Edhe sot gjendja e tyre paraqitet shumë e vështirë.

Eksploatuesit ilegalë përveç që nuk u ndëshkuan morën edhe tenderë në institucione të Kosovës, e disa prej tyre ishin edhe financues të partive politike.

TREGU I ILEGALËVE

Gjatë kohës së hulumtimit, Preportr ka siguruar dosjen e plotë të kompanive të licencuara. Pasi i ka parë raportet e KPM-së, ato të Doganave të Kosovës, importin e realizuar dhe sasinë e rërës që realizohet nga kompanitë e licencuara, ekipi jonë ka ardhur në përfundim se tregu në përqindje të madhe mbulohet me

rërë dhe zhavorr nga kompanitë e palicencuara, për faktin se këto kompani nuk paguajnë taksa dhe rrjedhimisht edhe çmimet i kanë shumë më të ulëta.

Për shembull, është gjetur se për një metër kub rërë, një kompani e licencuar i jep taksë shtetit 1.25 euro. Kjo i bie që për kategorinë e parë të rërës që është 0.1 një kompani e licencuar shet një metër kub rërë me 1.5 euro, kurse kompanitë e palicencuara e shesin këtë sasi me 10 euro e ndonjëherë edhe më lirë. Kategorinë e dytë të rërës, apo 0.2, kompanitë e licencuara e shesin me 8 euro, kurse ato të palicencuarat me 4-5 euro, e kështu me radhë.

KPM-ja nuk ka shifra se sa kompani të palicencuara që operojnë në Kosovë. Ajo ka vetëm evidencë të kompanive që i kanë zënë duke nxjerrë rërë ilegalisht. Prej vitit 2009 deri në vitin 2014 ky institucion i ka evidentuar 178 operues ilegalë që kanë kryer 207 operime ilegale (disa kompani janë zënë nga dy e më shumë herë duke eksploatuar rërë dhe zhavorr).

KPM-ja i ka dërguar disa prej këtyre rasteve në gjykatë, e të tjerat vetëm i ka identifikuar si operues ilegalë. Në 21 raste

kompanive të cilat i kanë zënë duke operuar ilegalisht ua ka konfiskuar makineritë.

Poashtu, gjatë këtij hulumtimi kemi vënë re se nuk ka një kontroll efikas ndaj operuesve ilegalë në mungesë të inspektorëve. Kompetencat në këtë fushë bien në shumë institucionet, prandaj edhe parandalimi i operimeve ilegale është më i vështirë.

Gjatë këtij hulumtimi Preportr ka siguruar të dhëna edhe nga Dogana e Kosovës, të cilat tregojnë se Kosova eksporton fare pak rërë e zhavorr, kurse importi është shumë më i madh. Pretendimet se me vendimin e Qeverisë së Kosovës i jepet më shumë hapësirë importit të këtyre mineraleve nga jashtë shtetit, e sidomos Serbisë, nuk mbështeten nga raportet e Doganës së Kosovës. Këto raporte tregojnë se gjatë kohës kur vendimi i qeverisë ishte në fuqi kishte një ngritje fare të lehtë të importit të rërës dhe zhavorrit i cili edhe ashtu nuk arrin të mbulojë tregun e vendit as përafërsisht.

Preportr ka kërkuar qasje në raportet e kompanive të licencuara, e që janë vetëm 20, për të parë se sa kanë planifikuar dhe sa kanë realizuar secila veç e veç që prej vitit 2008 deri në vitin 2015.

	PLANIFIKIMI	REALIZIMI
2011	125,851,000	38,611,220
2012	76,631,000	23,196,570
2013	72,906,000	25,398,550
2014	70,520,000	24,990,300

KPMM-ja nuk na ka lejuar qasje në këto raporte duke u thirrur në konfidencialitet të cilin, sipas tyre, ua garanton ligji.

“Raportet që i dorëzojnë kompanitë e licencuara në KPMM mbahen në mënyrë konfidenciale në bazë të nenit 34 paragrafi 5 në ligjin nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet”, thotë drejtori i KPMM-së, Midin Bojaxhiu.

Mirëpo, ata na kanë ftuar që t’i shohim disa prej raportimeve që kompanitë janë të detyruara t’i bëjnë në KPMM.

Në raportet e KPMM-së, Preportr ka gjetur se kompanitë e licencuara nuk arrijnë të realizojnë as 30-40 për qind të sasisë së rërës dhe zhavorrit të planifikuar. Për këtë, fajin ua hedhin kompanive të palicencuara dhe inspektoratit që nuk po merret më seriozisht me këta operues. Kryetari i Shoqatës të Eksploatuesve të Rërës dhe Zhavorrit Sami Çeku, pronar i kompanisë “Besniku Q”, që merret me eksploatim të rërës dhe zhavorrit, thotë se ka rreth 100 kompani të palicencuara që merren me këtë veprimtari.

EKSPLOATUESIT LEGALË NDIHEN TË ANASHKALUAR

Kompanitë e licencuara për eksploatim të rërës dhe zhavorrit të cilave, me Ligjin për Ujërat, u është caktuar distanca prej 150 metrash larg lumit për ta ushtruar këtë veprimtari, thonë se institucionet e Kosovës po përdorin standarde të dyfishta. Ata thonë se janë të detyruar të japin shumë para për ta marrë licencën dhe për ta mirëmbajtur atë. Më lart përmendëm se si KPMM-ja na ka lejuar të shohim raportimet e këtyre kompanive dhe kemi parë se ato raportojnë që nuk kishin eksploatur rërë dhe zhavorr për disa muaj. Arsytet më të shpeshta të tyre janë se nuk kanë llogari të eksploatojnë këto minerale pasi që ato nuk mund t’i shesin sepse çmimet e kompanive ilegale janë shumë më të ulëta.

“Ne jemi të detyruar të mos

punojmë me muaj pasi kemi shumë pagesa për të bërë. Kemi punë me shumë institucione dhe kjo na vështirëson shumë punën. Duhet të marrim leje e të lidhim kontrata me shumë institucione”, thotë Sami Çeku. Çeku, që është kushëri i ish komandantit të UÇK-së Agim Çekut, sipas evidencës së operuesve ilegalë që e ka bërë KPMM-ja, është zënë duke nxjerrë rërë e zhavorr ilegalisht në vitin 2010.

Megjithatë, në KPMM thonë se kanë qenë dorëlidur me kompanitë legale. Ata nuk kanë ndërmarrë asnjë masë ndëshkuese edhe kur këto kompani nuk kanë arritur të kryejnë detyrimet - në këtë rast, kur nuk kanë arritur të eksploatojnë rërën dhe zhavorrin që e kanë planifikuar.

“KPMM-ja nuk e ka parë të arsyeshme të ndërmerr masa ndëshkuese për mosrealizim të planifikimit, ngase, siç jeni në dijeni, ndërprerja e veprimtarisë ilegale për fat të keq nuk është duke u kryer. Në anën tjetër, ndërmarrja e masave ndëshkuese do të ishte një rëndesë shtesë për ndërmarrjet legale”, thonë në KPMM.

HEKTARË TË TËRË TË SHITRËTËRVE TË LUMENJVE U DEGRADUAN

Menjëherë pas luftës, në Kosovë filloi të zhvillohet hovshëm sektori i ndërtimeve. Si rrjedhojë u shtuan kërkesat për rërë dhe zhavorr. Kompanitë e shfrytëzuan rastin duke vendosur makineri afër lumenjve dhe duke eksploatuar rërë dhe zhavorr pa kurrfarë kriteri. Atyre madje nuk u është dashur të investojnë shumë - vetëm të blejnë makinërinë dhe të fillojnë punën pa e kryer asnjë obligim ndaj shtetit.

Preportr ka siguruar një raport që e ka bërë Agjencioni i Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM), i cili tregon se sa hektarë të lumenjve janë degraduar gjatë viteve 2009-2012. Sipas këtij raporti, në vitin 2009

Operuesit ilegalë sipas komunave

GJAKOVA	46	LIPJAN	3
PEJA	29	MALISHEVË	1
RAHOVEC	21	MITROVICË	1
DEÇAN	4	OBILIQ	4
DRAGASH	3	PODUJEVË	1
DRENAS	1	PRISHTINË	5
FERIZAJ	3	PRIZREN	13
KAÇANIK	6	RANIGULL	2
GJILAN	7	SHTËRPECË	1
GLLOGOC	1	SHTIME	1
GRAÇANICË	3	SKENDERAJ	2
ISTOG	6	SUHAREKË	1
JUNIK	3	VITI	1
KAMENICË	12	VUSHTRRI	3
KLINË	10	ZUBIN POTOK	1

janë degraduar 1004.77 hektarë sipërfaqe të lumenjve. Ndërsa në vitin 2012, megjithëse vendimi i qeverisë ishte në fuqi, kjo sipërfaqe e degraduar arriti në 1219.23 hektarë.

Sipas këtyre të dhënave, lumi që ka pësuar më së shumti është Drini i Bardhë, pasi që në vitin 2009 ishin degraduar 861.1 hektarë të tij, kurse në vitin 2012 sipërfaqet e degraduara të këtij lumi arritën në 1011.75 hektarë. Pas Drinit të Bardhë radhitet Lumbardhi i Pejës. Këtij lumi në vitin 2009 i ishin degraduar 93.36 hektarë sipërfaqe, ndërsa, në vitin 2012 sipërfaqet e degraduara arritën në 134.5 hektarë.

Në Erenikun e Gjakovës 16.28 hektarë ishin të degraduara në vitin 2009. Në vitin 2012 kjo sipërfaqe arriti në 19.48 hektarë.

Këto të dhëna tregojnë se lumenjtë e Rrafshit të Dukagjinit janë më të dëmtuarit nga operatorët ilegalë. Pas tyre vinë lumenjtë e Komunës së Kamenicës, kurse as Ibri i Mitrovicës nuk i ka shpëtuar degradimit.

Në Kamenicë, lumi Desivojë në vitin 2009 kishte 7.76 hektarë të degraduar, ndërsa në vitin 2015 degradimi është dyfishuar duke arritur në 18.95 hektarë të degraduar. Krivareka në vitin 2009 kishte 19.37 hektarë të degraduar, kurse në vitin 2012 degradimi është rritur në 25.26 hektarë.

Në Moravën e Binçës nuk ka pasur degradim shumë të theksuar në periudhën 2009 - 2012. Në vitin 2009 kishte 4.29 hektarë të degraduar, kurse në vitin 2012 sipërfaqja e degraduar arriti në 4.79 hektarë. Duhet theksuar se lumenjtë e Komunës së Kamenicës kanë hapësirë shumë më të vogël sesa ata të Rrafshit të Du-

kagjinit. Ibri, nga 2.64 hektarë të degraduar me 2009, në vitin 2012 arriti në 4.5 hektarë të degraduar.

Një raport i vitit 2010 për gjendjen e ujërave në Kosovë, i realizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, konstaton se degradimi i lumenjve ka marrë përmasa shqetësuese dhe përmenden disa prej lumenjve që janë ndër më të degraduarit. Lumenjtë më të dëmtuar sipas këtij raporti janë në pellgun e lumit Drini i Bardhë, që është më i dëmtuari, pastaj lumi Ereniku si dhe një pjesë e Lumëbardhit të Pejës.

Box 2

Në raport theksohet edhe rreziku nga përmytjet. “Ndër faktorët kryesorë që shpijnë deri te përmytjet janë shtretërit e parregulluar të lumenjve dhe dëmtimi i shtretërve të tyre nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit pa ndonjë kriter”.

Raport më të detajuar mbi dëmtimin e lumenjve nga eksploatimi pa kriter i rërës dhe zhavorrit nuk ka. Megjithatë, Preportr ka arritur të sigurojë një raport të brendshëm të Agjencionit të Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, në bazë të të cilit kuptohet se gjendja e lumenjve nga eksploatimi pa kriter i rërës dhe zhavorrit është mjaft e rëndë me tendencë të përqesimit, e sidomos kur kjo nuk ndodh vetëm në lumenjtë e mëdhenj të Rrafshit të Dukagjinit, por edhe në Komunën e Kamenicës, rajon ky që njihet për mungesë të ujit.

“Pas vendimit të ministrit (nr.02/46, datë 02.11.2011), inspektorati i MMPH-së ka realizuar gjithsej 103 inspektime në terren të seperacioneve të rërës dhe zhavorrit në gjithë territorin e Kosovës”, thuhet në raport. Pasi

tregohet për lumenjtë më të dëmtuar nga këto ndërhyrje, në këtë raport të realizuar në vitin 2012 theksohet se pavarësisht faktit se vendimi i Qeverisë së Kosovës ishte në fuqi, shumica e operatorëve vazhduan punën.

“Si masë ndëshkuese ndaj operatorëve për mosrespektimin e vendimit u është tërhequr vërejtja me procesverbal si dhe u janë bërë inicime në Gjykatën për Kundërvajtje. Si masë ndëshkuese në Gjykatën për Kundërvajtje u dërguan gjithsej 34 operatorë, ku 16 prej tyre u shqyrtuan nga gjykata në nivel të Kosovës. Gjithashtu, pas vendimit nr. 02/46, u bënë 21 konfiskime të makinerisë me ndihmën e KPMM-së dhe Policisë së Kosovës”, thuhet në raport.

Duke u bazuar në raportet e mëhershme mbi ambientin, vizitat në terren nga inspektorati i MMPH-së si dhe vizitat e komisionit për vlerësim të gjendjes së lumenjve, u bë evidentimi i pikave të nxehta të degradimit.

“Duke u bazuar në të gjitha burimet e informacioneve, si dhe në vizitat në terren, vlerësojmë se gjendja e lumenjve vazhdon të përqesohet në masë të madhe nga eksploatuesit”, thuhet në raport.

U NDALËN EKSPLOATUESIT, U SHTUAN GURTHYESIT

Vendimi i Qeverisë së Kosovës nuk e rriti importin e rërës dhe zhavorrit, por i dha fuqi një kategorie tjetër që ta mbulojë tregun për nevojat e ndërtimit, e këta janë gurthyesit që, sipas ekspertëve, mund ta dëmtojnë rëndë ambientin, njëjtë si eksploatuesit e rërës dhe zhavorrit.

Në një evidencë që Preportr e ka bërë në listën e gurthyesve të

licencuar vërehet se në periudhën 2012- 2015 - periudhë kjo kur vendimi i Qeverisë së Kosovës ishte në fuqi - u licencua një numër i madh gurthyesish, që përbën dyfishin e atyre që kanë qenë më parë.

Në listën e kompanive të licencuara për hulumtim dhe shfrytëzim, e cila është publike në uebfaqen e KPMM-së, shihet se pas vitit 2010 u shtua interesimi i kompanive që kanë aplikuar për hulumtim dhe shfrytëzim të gurit të fortë.

Ministria e Mjedisit akuzohej nga kompanitë që nxjerrin inerte se vendimi i saj për ndalim të tërësishëm të këtij minerali ishte bërë me qëllim që t’u jepej më shumë hapësirë gurthyesve. Ish ministri i MMPH-së Dardan Gashi, gjatë një interviste për Preportr, ka pranuar se kanë pasur edhe këso akuzash, por se ai ka qenë më shumë në favor të asaj që eksploatuesve të rërës dhe zhavorrit t’u ndërpritej hovi, duke marrë parasysh këtu resurset e pakta të ujit që i ka Kosova.

“Tash, prej diçkaje duhet të ndërtohet. Mund të them se Kosova ka më shumë kodra se lumenj nëse duam ta banalizojmë këtë punë atë që e kemi më pak ia vlenë ta ruajmë më shumë”, thotë ai.

Gashi e pranon se nuk kanë bërë shumë që të ndalin punën e gurthyesve. Ai thotë se kishin bërë plane që me këtë punë të merren pas lumenjve, por se mandati i tij përfundoi.

Njohësi i fushës së ambientit, Zeqir Veselaj, thotë se ambientin e dëmtojnë shumë si eksploatuesit e rërës dhe zhavorrit ashtu edhe gurthyesit. Ai tregon se si gurthyesit, pasi nxjerrin gurin, duhet ta rehabilitojnë hapësirën ku e kanë kryer këtë veprimtari, por ata në asnjë rast nuk e kanë bërë një gjë të tillë.

Sa i përket eksploatimit të rërës dhe zhavorrit, ai thotë se dëmet janë shumë të mëdha dhe të pariparueshme për dekada të tëra.

ZINGJIRI I PASOJAVE NGA GËRRYERJA E SHTRËTËRVE TË LUMENJËVE

Kudo që gropohet afër lumenjve del rëra dhe zhavorri. Preportr ka dalë në terren dhe ka parë gropime të reja afër lumenjve, fakt që tregon se operatorët ilegalë e vazhdojnë punën pa i penguar askush. Gropat e mëdha në shumë pjesë të lumenjve shihen se e kanë devijuar rrjedhën e lumit. Njohësit e fushës së ambientit thonë se kjo është shumë e rrezikshme dhe paraqet potencial të madh për vërshime dhe dëme tjera që mund të bëhen nga këto devijime.

Ish ministri i MMPH-së, Dardan Gashi, mendon se vendimi i Qeverisë së Kosovës për ndalimin e tërësishëm të eksploatimit të

rërës dhe zhavorrit nga shtretërit e lumenjve është zbatuar rreth 70 deri 80 për qind.

Ai tregon se si në fillim e akuzonin se po e pengonte biznesin dhe thotë se qëllimi i tij ishte ta ndërprente tërësisht këtë biznes, pasi ai ishte shumë shkatërrues për lumenjtë e Kosovës.

Megjithatë, vendimi nuk ishte marrë bazuar në një studim paraparak.

“Studim në kuptim shkencor nuk e di që ka pasur, ka pasur dëmtime, dokumentacione që e kane alarmuar këtë çështje. Ka pasur probleme me viktima në njerëz, viktima në bagëti prej devijimit të shtretërve të lumenjve, vërshimeve, dëme materiale nëpër fshatra prej devijimit, pikërisht atje ku është prekë në mënyrë të padrejtë shtrati i lumit”, thotë ai.

Incizimet nga ajri që i kishte bërë KFOR-i, Ministrisë së Mjedisit i shërbyen si bazë që ta shtyn-te përpara këtë çështje.

“Është parë sidomos në vjeshtë dhe pranverë dëmi i madh që është duke u shkaktuar prej devijimit të shtretërve të lumenjve. Mos të flasim për aspektin biologjik të lumenjve që në atë zonë ku intervenohet është totalisht i shkatërruar, në kuptim të gjallesave që kanë jetuar aty”, thotë Gashi.

Ai përmend bashkëpunimin e mirë që e kanë pasur me banorët që jetojnë afër zonave të degraduara. Sipas tij, ata e kanë informuar këtë ministri për dëmet që u bëheshin lumenjve.

Ish ministri Gashi përmend edhe një mori arsyesh të tjera për nxjerrje të vendimit për ndalimin e tërësishëm të eksploatimit të rërës dhe zhavorrit në shtretër të lumenjve.

“Banorët e kanë përdorë atë ujë për ujitje të arave të tyre prej një kanali të caktuar. Më ata ujë nuk ka ekzistuar, ka shkuar tjetër kah po e zëmë, ose rënia e nivelit prej gropave që janë hapur e ka shtjerrë rrjedhën e lumit, do të thotë s’ka mundur lumi më që ta bart. Në qytete si në Pejë, Gjakovë e disa qytete të tjera ka pasur probleme edhe shëndetësore”, thotë ai.

Problemet shëndetësore, sipas tij, kanë ndodhur nga rënia e nivelit të ujit dhe, fatkeqësisht, nga përdorimi i lumenjve për kanalizim, “ka ndodhur që fekalet kanë mbetur nëpër rrjedhë të lumit, nuk ka mundur më lumi që t’i bartë dhe ka shkaktuar edhe probleme tjera serioze”.

Gashi thotë se ata e kanë ditur se do të kenë konfrontim sepse nuk është e lehtë të mbyllen 130 kompani brenda natës.

“Mandej ka qenë frika se do të dëmtohet edhe industria e ndërtimit, mirëpo për këtë kemi pasur një studim që nuk dëmtohet në asnjë mënyrë, se zëvendësohet

Krahasimi i kompanive që janë zënë ilegalisht dhe kur kanë aplikuar pastaj për licencë

1. COMPANY “TINI” SH.P.K.

-nga Gjakova me datën 01.07.2010 është zënë duke operuar ilegalisht. Ndërsa me datën 17.06.2010 e ka marrë licencën për hulumtim, e cila i ka skaduar më 16.06.2012. Me 28.08.2012 kjo kompani ka marrë licencë për shfrytëzim, e cila ka afat deri më 04.08.2020.

2. “UNION COMERC” SH.P.K.

-me datat 28.10.2010 dhe 26.06.2014 është zënë duke operuar ilegalisht. Ndërsa me datën 18.04.2012 e ka marrë licencën për shfrytëzim, e cila i ka skaduar më 15.03.2014. Me 09.06.2014 ka marrë përsëri licencë për shfrytëzim, e cila i ka skaduar më 01.11.2015.

3. “ERMALI” SH.P.K.

-nga Gjakova me datën 05.11.2009 është zënë duke operuar ilegalisht. Me 18.04.2012 ka marrë licencë për shfrytëzim, e cila i ka skaduar më 04.05.2014. Me 27.09.2013 ka marrë licencë për hulumtim, e cila i ka skaduar më 12.09.2015.Me 14.03.2014 ka marrë licencë për shfrytëzim, e cila ka afat deri më 03.03.2020.

4. “GASHI “ SH.P.K.

-nga Peja me datën 16.09.2010 është zënë duke operuar ilegalisht. Me 18.04.2012 e ka marrë licencën për shfrytëzim, e cila i ka skaduar më 13.09.2014.

5. “GURTHYESI “ SH.P.K

-nga Peja me datën 26.04.2010 është zënë duke operuar ilegalisht. Me 19.04.2012 ka marrë licencë për shfrytëzim, e cila i ka skaduar më 18.04.2013. Me 12.06.2013 ka marrë licencë tjetër për shfrytëzim, e cila ka afat deri më 07.06.2016.

6. ”DACI “ SH.P.K.

-nga Peja me datën 28.10.2010 është zënë duke operuar ilegalisht. Me datën 19.04.2012 ka marrë licencë për shfrytëzim, e cila ka afat deri më 04.10.2016.

7. “BETONJERKA” SH.P.K.

-nga Peja, me datën 26.04.2010 është zënë duke operuar ilegalisht. Me 18.04.2012 ka marrë licencë për shfrytëzim, e cila i ka skaduar me 04.10.2015.

8. “BESNIKU - Q “ SH.P.K.

-nga Peja, me datën 16.09.2010 është zënë duke operuar ilegalisht. Me 18.04.2012 ka marrë licencë për shfrytëzim, e cila i ka skaduar më 10.10.2012. Me 29.04.2013 ka marrë licencë tjetër për shfrytëzim, e cila ka afat deri më 28.03.2017.

9. ”LUANI TRANSPORT “ SH.P.K.

-nga Peja, me datat 25.08.2010 dhe 18.03.2011 është zënë duke operuar ilegalisht. Me 27.04.2012 e ka marrë licencën për shfrytëzim, e cila i ka skaduar më 27.07.2014.

10. ”NDËRTIMI” SH.P.K

-nga Peja, me datën 28.10.2010 është zënë duke operuar ilegalisht. Me 26.07.2013 e ka marre licencën për shfrytëzim, e cila ka afat deri më 17.07.2018.

11. “ARBRI-EB” SH.P.K

-nga Gjakova, me datën 07.05.2014 është zënë duke operuar ilegalisht. Me 14.04.2014 ka marrë licencë për hulumtim, e cila ka afat deri më 30.03.2016.

12. “QALLAKU PETROLL” SH.P.K.

-nga Peja, me datën 16.09.2010 është zënë duke operuar ilegalisht. Me 02.05.2014 ka marrë licencë për shfrytëzim, e cila i ka skaduar më 27.12.2014.

FOTO E BËRË NGA KFOR-I



lehtë me gurë tjerë e ndoshta edhe më sigurtë për aspekt të ndërtimit se ky zhavorr nuk është i sigurt të përdoret në ndërtime të larta sidomos, për shkak të përbërjes që e ka”, thotë ai.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës është përkrahur nga persona dhe OJQ që merren me mbrojtjen e ambientit. Njëri nga ta, Zeqir Veselaj, thotë se ky është vendimi më i mirë që e ka marrë qeveria, pasi lumenjtë janë dëmtuar shumë pas luftës.

ARSYETIMET E INSTITUCIONEVE

Shteti është treguar i pa-fuqishëm në pengimin e operatorëve ilegalë që nxjerrin rërë dhe zhavorr pa kritere nga lumenjtë. Ata kanë përmendur mungesën e inspektorëve, bashkëpunimin jo të mirë të institucioneve, atyre të nivelit lokal dhe qendror dhe, në rastet më të shpeshta, faji u është lënë gjykatave që nuk kanë qenë shumë efikase në trajtimin e lëndëve që për subjekt kanë dëmtuesit e lumenjve.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale për mos-suksesin në terren arsyetohet me mungesë të inspektorëve.

“Numri i inspektorëve për inspektim të këtyre aktiviteteve është tepër i vogël kur dihet fakti se kemi katër ndërmarrje të mini-erave nëntokësore: “Trepça”, KEK, “Sharr Cem” dhe “Ferronikeli”, thotë Jahir Gashi, kryeins-

pektor i KPMM-së.

Në Ministrinë e Mjedisit thonë se ka qenë e pamundur të ndalohet tërësisht veprimtaria e kompanive ilegale pasi është hasur në vështirësi të shumta në terren. Disa prej operuesve kanë ikur nga vendi i ngjarjes, ose kanë punuar pas orarit të punës.

“Për këtë kohë, në vitet 2008-2011, duhet të potencojmë se gjatë daljes së Inspektoratit në terren operatorët ilegalë kanë ikur vazhdimisht nga vendi i ngjarjes duke i lënë makinerinë në vendin e veprimit. Makinaria, pra ekskavatorët kanë qenë pa targa të regjistrimit dhe si rrjedhojë e kanë pamundësuar veprimin konkret të marrjes së masave nga ana e Inspektoratit për shkak të pamundësisë së identifikimit të keqbërësve”, thotë Agim Qehaja, këshilltar i ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ferid Aganit.

Edhe Dardan Gashi ankohet për mosfunksionim të zingjirit institucional, si një prej arsyeve që vendimi i Qeverisë atë kohë nuk u zbatua plotësisht. Sipas tij, pikat më të largëta prej qendrave nuk kanë mundur t’i kontrollojnë, e madje as bashkëpunimi me komuna dhe disa institucione të tjera nuk ka qenë i mirë.

“E kemi pasur shumë të vështirë pasi në fillim inspektorët tanë janë pritur me kallashnikovë prej pronarëve të kompanive, ata (kompanitë) njëjtë kanë pasur

probleme me banorët”, thotë ai.

Mirëpo ajo që Preportr ka gjetur gjatë hulumtimit është edhe fakti se inspektorët janë të partive politike. Ata janë zënë duke u bërë favore kompanive të ndryshme, ose duke u kanë kërkuar ryshfet atyre. Sa për ilusttrim, po japim vetëm shembuj të kryeinspektorëve të MMPH-së dhe KPMM-së.

Kryeinspektori i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Bedri Halimi, ka kandiduar në radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për deputet të Kuvendit të Kosovës në zgjedhjet e vitit 2014; përfshirja e kryeinspektorit dhe inspektorëve të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në korupsion (kryeinspektori Nuredin Bislimi dhe një inspektor, Lulzim Çitaku, janë dënuar në gjykatë për marrje ryshfeti); gruaja e ushtruesit të detyrës së kryeinspektorit të KPMM-së, Jahir Gashit, punon në gurthyesin “Mineral L.L.C” në Drenas. KPMM-ja i jep licencat për gurthyesit, inspektorati i kontrollon nëse ato realizohen siç duhet.

Institucionet si KPMM-ja dhe MMPH-ja ankohen se nuk kanë pasur raporte të mira edhe me gjykatat. Këto të fundit, sipas tyre, nuk i kanë trajtuar me prioritet lëndët që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit dhe në rastet kur i kanë trajtuar ato vendimet kanë qenë gjithmonë në

KOMPANITË E GURTHYESVE QË U LICENCUAN NDËR VITE

favor të shkelësve të ligjit.

KPMM-ja ka ngritur dhjetëra kallëzime penale dhe ka shqiptuar dhjetëra gjopa ndaj kompanive që e kanë shkelur ligjin. Sipas të dhënave të KPMM-së, në vitin 2010 u ngritën 144 kallëzime penale, më 2011 u ngritën 91 kallëzime, më 2012 dhe 2013 nga 44 kallëzime penale, më 2014 u ngritën 77 kallëzime kurse me 2015, deri në shtator, 27 kallëzime.

Një aktgjykim që e ka siguruar Preportr për një eksplotues ilegal në anën e Komunës së Kamenicës, si arsye të gjykatës për të shfajësuar të akuzuarin ishte mugesia e provave të mjaftueshme për ta dëshmuar se i akuzuari i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohej. Për shembull, në aktgjykim, një nga arsyet për shfajësim të operuesit ilegal përmendet fakti se ai ka punuar në tokën që është pronë e tij.

Gjykata i kishte hedhur poshtë pretendimet e prokurorisë se i akuzuari kishte kryer vepra penale, vjedhje sipas nenit 252 paragrafi i parë, se kishte shkakuar rrezik të përgjithshëm nga neni 291 paragrafi i parë, dhe ndotje ose shkatërrim të mjedisit sipas nenit 276 paragrafi i parë i Kodit Penal të Kosovës. Në pikën e parë gjykata gjeti se i akuzuari ka nxjerrë rërë dhe zhavorr në pronën e tij dhe rrjedhimisht ai mund të bëjë çfarë të dojë me pronën e tij.

“Pasuritë nëntokësore janë

207

OPERIME ILEGALE

2009: **15**

2010: **79**

2011: **58**

2012: **15**

2013: **5**

2014: **25**

2015: **10**

LUMENJTË MË TË DEGRADUAR SIPAS RAPORTIT

► DRINI I BARDHË

► LUMBARDHI I PEJËS

► LUMI ERENIKU-GJAKOVË

► LUMI DESIVOJCË-KAMENICË

► LUMI KRIVAREKË-KAMENICË

► LUMI IBRI NË MITROVICË

2014

53 KOMPANI

25 LICENCA PËR HULUMTIM

28 LICENCA PËR SHFRYTËZIM

2013

59 KOMPANI

31 LICENCA PËR HULUMTIM

28 LICENCA PËR SHFRYTËZIM

2012

14 KOMPANI

1 LICENCA PËR HULUMTIM

13 LICENCA PËR SHFRYTËZIM

2011

16 LICENCA PËR SHFRYTËZIM

2010

15 LICENCA PËR SHFRYTËZIM

2009

12 LICENCA PËR SHFRYTËZIM

2008

19 LICENCA PËR SHFRYTËZIM

2007

8 LICENCA PËR SHFRYTËZIM

2006

9 LICENCA PËR SHFRYTËZIM

2005

4 LICENCA PËR SHFRYTËZIM

KOMPANITË QË KANË NXJERR RËRË DHE ZHAVORR
ILEGALISHT, KANË MARRË TENDERË NË INSTITUCIONE

OPERUESIT ILEGAL DONATORË TË SUBJEKTEVE POLITIKE

ALKO IMPEX - ka marrë nëntë tenderë në MTPT dhe MI në vlerë 12,339,580€

1.Mirëmbajtja dimërore e rrugëve magjistrale dhe regjionale të Kosovës Regjioni I Mitrovices A (MTPT)

Vlera: **350,475€**

Viti: **2008**

2.Ndërtimi i rrugës dheu i kuq Llugovicë - Hajkobillë (MTPT)

Vlera: **3,690,942€**

Viti: **2008**

3.Zgjerimi i rrugës M2 ,pjesa Çagllavicë - M2/M25 (QMI)km 1+600 deri km 5 +200 faza e dytë, Lot I, km 5+200 deri km 8+000 - faza e dytë, Lot II (MTPT)

Vlera: **1,839,437€**

Viti: **2008**

4.Zgjerimi i rrugës Magjistrale M2: Prishtine - Hani i Elezit, Segmenti: Vazhdim i zgjerimit nga Çagllavica deri te udhëkryqi M2&M25-"QMI (MTPT)

Vlera: **1,780,172€**

Viti: **2007**

5.Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale të Republikës së Kosovës 2013/2014- Mitrovica A (MI)

Vlera: **138,664€**

Viti: **2013**

6.Rehabilitimi i rrugës Nacionale, Prishtinë-Mutivodë (MI)

Vlera: **1,277,755€**

Viti: **2012**

7.Ndërtimi i rrugës tranzite për Shtime -faza e II-të (në konzorcium me "Ipe Proing") (MI)

Vlera: **727,864€**

Viti: **2011**

8.Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale të Republikës së Kosovës 2011/2014 (MI)

Vlera: **1,177,777€**

Viti: **2011**

9.Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale të Republikës së Kosovës 2011/2013 Mitrovica A (MI)

Vlera: **1,356,474€**

Viti: **2011**

"LIKA TRADE" - ka marrë nëntë tenderë në MTPT dhe MI në vlerë 11,953,486€

1.Asfaltimi i rrugës Irzniq-Ratishë, faza e II-të (MTPT)

Vlera: **389,872€**

Viti: **2008**

2.Asfaltimi i rrugës lokale në fshatin Strelc, L=1250m (MTPT)

Vlera: **108,301 €**

Viti: **2010**

3.Ndërtimi i rrugës në hyrje të qytetit të Pejës nga Prishtina (MI)

Vlera: **2,144,318 €**

Viti: **2013**

4.Asfaltimi i rrugës lokale Rashiq-Turjakë (MI)

Vlera: **389,700 €**

Viti: **2012**

5.Asfaltimi i rrugës Botushë-Koshare (MTPT)

Vlera: **1,598,840 €**

Viti: **2009**

6.Zgjerimi i rrugës nacionale M9, segmenti Sllatinë-Gjurgjicë i ndarë në 5 lote (në konzorcium me "Granit" dhe "Malsija") (MTPT)

Vlera: **6,462,300€**

Viti: **2009**

7.Asfaltimi i rrugës Irzniq - Ratishë (MTPT)

Vlera: **298,955 €**

Viti: **2008**

8.Asfaltimi i rrugës Lumbardh - Broliq (MI)

Vlera: **293,476 €**

Viti: **2013**

9.Ndërtimi i rrugës - Kodrali K. Deçan me L=2,600.55m (MI)

Vlera: **267,724 €**

Viti: **2013**

Muhamet Spahiu i cili është person i autorizuar në **NEWCO MIRUSHA** ka dhënë donacion **10,000€** në vitin **2010** për **AAK-NË**

Bujar Shabani i cili është pro-nar i **"BAGERI COMPANY"** ka dhënë donacion **1,000€** në vitin **2009** për **PDK-NË**

"RENELUAL TAHIRI" ka dhënë donacion **1,000€** në vitin **2012** për **PDK-NË**

KOMPANITË QË KANË NXJERR RËRË DHE ZHAVORR ILEGALISHT, KANË MARRË TENDERË NË INSTITUCIONE

“ENGINEERING “ - ka marrë 3 tenderë në MASHT, në vlerë totale 3,561,790 euro.

Por ky biznes në ARBK del se është shuar (pa caktim date)

TITULLI I KONTRATËS: Vazhdim i punëve në objektin e shkollës fillore në Suharekë

Vlera: **68,373 €**

Viti: **2009**

TITULLI I KONTRATËS: Ndërtimi i shkollës fillore në Mushtisht - Suharekë

Vlera: **1,999,438 €**

Viti: **2009**

TITULLI I KONTRATËS: Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në Suharekë, faza e I-rë

Vlera: **1,493,979 €**

Viti: **2008**

“COMPANY ZUKA COMMERCE” - ka marrë dy tenderë në MI në vlerë 963,891€

1.Asfaltimi i Rrugës Pogradje - Llovçë

Vlera: **468,561€**

Viti: **2012**

2.Asfaltimi i rrugës në fshatin Smirë, l=2239.61m (K.Viti)

Vlera: **495,330€**

Viti: **2009**

BAGERI - ka marrë katër tenderë në MI në vlerë 7,397,254€

1.Rehabilitimi i rruges magjistrale M25.2 Prishtinë-Gjilan ,pjesa Hajvali-Mramuer (MTPT)

Vlera: **829,569 €**

Viti: **2008**

2.Zgjerimi i Rrugës M2 - Segmenti: Milloshevë-Vushtrri (sektori: Milloshevë-Lum i Madh), Lot 1, Lot2 dhe Lot6 (në konzorcium me “R&Rukolli”) (MI)

Vlera: **3,825,397 €**

Viti: **2013**

3.Ndërtimi i Rrugës Shkabaj - Qendra e Panairëve (MI)

Vlera: **848,400 €**

Viti: **2013**

4.Asfaltimi i Rrugës Ferizaj-Nerodime - segmenti Ura e Jezercit (MI)

Vlera: **1,893,888 €**

Viti: **2012**

“TONING” - ka marrë gjithsej tre tenderë në MASHT në vlerë 5,168,279€

1.Ndërtimi i shkollës se mesme në Fushë Kosovë

Vlera: **1,655,215 €**

Viti: **2009**

2.Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Turqevc-Skenderaj

Vlera: **1,504,699 €**

Viti: **2009**

3.Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Prishtinë

Vlera: **2,008,365 €**

Viti: **2008**

N.P.“VICTORIA INVEST INTERNATIONAL” SH.P.K -

ka marrë 13 tenderë në MTPT dhe MI në vlerë 11,659,419€

1.Mirëmbajtja dimërore e rrugëve magjistrale dhe regjionale të Kosovës Regjioni i Gjakovës (MTPT)

Vlera: **310,241 €**

Viti: **2008**

2.Ndërtimi i rrugës Turqevc - Aqaravë (MTPT)

Vlera: **1,228,885 €**

Viti: **2008**

3.Asfaltimi i rrugëve ne lagjen Isufaj ,Berishaj - Llapushnik (MTPT)

Vlera: **379,096 €**

Viti: **2008**

4.Rekonstruimi i rrugës regjionale R 222,pjesa Bellobrad-Bresan,L=2.71 km (MTPT)

Vlera: **219,434 €**

Viti: **2007**

5.Asfaltimi i rrugës për fshatin Gjergjiçë (MTPT)

Vlera: **312,363 €**

Viti: **2009**

6.Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale të Republikës së Kosovës 2013/2014 regjioni; Gjakova (MI)

Vlera: **987,677 €**

Viti: **2013**

7.Ndërtimi i rrugës Mushtisht-Budakovë-Jezerc-Ferizaj, Lot 1 dhe Lot 2 (në konzorcium me Erniku) (MI)

Vlera: **988,315 €**

Viti: **2013**

8.Ndërtimi i rrugës Pejë - Tërstenik (MI)

Vlera: **1,937,283 €**

Viti: **2013**

9.Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale të Republikës së Kosovës 2011/2022 (MI)

Vlera: **1,150,025 €**

Viti: **2011**

10.Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale të Republikës së Kosovës 2011/2021 Gjakovë (në konzorcium me “Euro Famis”) (MI)

Vlera: **1,131,929 €**

Viti: **2011**

11.Rikonstruimi i rrugës Llukaç - Tomoc (MTPT)

Vlera: **482,400 €**

Viti: **2010**

12.Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Runik-Leqinë-Izbicë (MTPT)

Vlera: **2,016,541 €**

Viti: **2009**

13.Asfaltimi i rrugës, Novosellë-Lipë, faza e dytë-K.e Pejës (MI)

Vlera: **515,230 €**

Viti: **2013**

“RENELUAL TAHIRI” - ka marrë katër tenderë në MI dhe MTPT në vlerë 1,298,225€

1.Ndërtimi i rrugës Grejkoc - Sallagrahdë (MTPT)

Vlera: **644,045 €**

Viti: **2008**

2.Ndërtimi i nënkalimit në fshatin Zhur (MI)

Vlera: **123,223 €**

Viti: **2013**

3.Ndërtimi i rrugërtimi i rrugës lokale Brod - qendra turistike, L=2.585 km (MI)

Vlera: **313,536 €**

Viti: **2013**

4.Zgjerimi i rrugës R107, segmenti: varrezat e dëshmorëve - ura e Landovicës (MI)

Vlera: **217,421 €**

Viti: **2012**

“BENITA COMPANY”SH.P.K. - ka marrë një tender në konzorcium me Mirusha Transport në MTPT

1.Asfaltimi i rruges lokale, Ali Kelmendi (Komuna Klinë)

Vlera: **132,719 €**

Viti: **2008**

**“PASURITË
NËNTOKËSORE
JANË TË MIRA
TË PËRGJITH-
SHME, POR NË
SITUATA TË
TILLA SHPAL-
LET INTERESI
I PËRGJITH-
SHËM PUBLIK,
BËHET SHPRO-
NËSIMI DHE
TOKA KALON
NË PRONËSI TË
SHTETIT”**

SIPËRFAQET E DEGRADUARA SIPAS LUMENJËVE

DRINI I BARDHË	861.1	2009	1011.75	2012
IBRI	2.64		4.5	
MORAVA E BINQES	4.29		4.79	
LUMBARDHI I PEJËS	93.36		134.5	
ERENIKU	16.28		19.48	
KRIVAREKA	19.37		25.26	
DESIVOJCA	7.76		18.95	

të mira të përgjithshme, por në situata të tilla shpallet interesi i përgjithshëm publik, bëhet shpronësimi dhe toka kalon në pronësi të shtetit”, thuhet në aktgjykim.

Edhe sa i përket veprës tjetër penale, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, gjykata gjeti se prokuroria nuk kishte arritur të argumentojë rrezikun që i pandehuri ka mundur të shkaktonte me vendosjen e makinerisë aty dhe me hapjen e gropës.

“Pra prokurori do të duhej ta përshkruante qartë veprimin e rrezikshëm: cilat ishin dimensionet e asaj grope, gjerësia, thellësia, lokacioni, a kishin qasje në atë rrugë dhe afër saj njerëzit, kafshët”, thuhet në aktgjykim.

Edhe në nenin e fundit, atë të ndotjes dhe shkatërrimit të ambientit, prokuroria nuk e bindi gjykatën se i akuzuari e kishte kryer këtë vepër penale.

Gjykata nuk e mohoi në aktgjykim se ky i akuzuar kishte ushtruar këtë veprimtari pa licencë që lëshohet nga KPMM-ja.

NJË PLAN PËR NDALIMIN E EKSPLOATIMIT TË LUMENJVE

Pas skadimit të afatit të Vendimit të Qeverisë për ndalimin e operimit të të gjithë operatorëve në shtretërit, brigjet dhe hapësirat përreth lumenjve për periudhën trevjeçare, me iniciimin e Kabinetit të Ministrit Ferid Agani, Ministria e Mjedisit dhe

Planifikimit Hapësinor (MMPH) së bashku me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) hartuan një plan të veprimit për ndalimin e veprimeve ilegale në sektorin mineral. Ky plan që është në fazën finale që pritet të procedohet për aprovim në Qeverinë e Kosovës parasheh veprimet që duhet ndërmerren për ndalimin e veprimeve ilegale në këtë sektor.

“Për implementimin e këtij plani janë planifikuar të kyçen të gjitha institucionet që kanë qasje qoftë të drejtpërdrejtë qoftë edhe indirekte në këtë veprimtari”, thotë këshilltari i ministrit Agani, Agim Qehaja

Kështu, përpos KPMM-së dhe MMPH-së në implementimin e këtij plani është e pëfshirë edhe MPB-ja përmes Policisë së Kosovës, Ministria e Financave përmes Administratës Tatimore të Kosovës, Ministria e Drejtësisë përmes Agjencisë për Administrim të Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Të gjitha këto hallka të këtij zinxhiri të veprimit institucional, sipas ministrit, pritet t’i pamundësojnë operimet e mundshme ilegale në këtë sektor.

Po ashtu, MMPH-ja në një afat të afërt do të bëjë një analizë

të gjendjes së lumenjve në terren.

“Për të folur për gjendjen e lumenjve duhet të kemi një analizë të saktë, për një gjë të tillë duhet të bëhet studim i gjendjes duke bërë krahasimin mes periudhave të ndryshme kurse për masat që ka ndërmarrë inspektorati në vazhdimësi ndaj operatorëve ilegalë së bashku me KPMM-në kudo që i ka hasur ka bërë konfiskimin e 21 rasteve të makinerisë eksploatuese”, thotë Qehaja.

Sa i përket vendimit paraprak të Qeverisë së Kosovës për ndalim të tërësishëm të eksploatimit të rërës dhe zhavorrit, në ministri thonë se ky vendim ka pasur ndikim, por në disa raste është keqpërdorur nga eksploatuesit ilegalë.

“Duhet theksuar se ndalimi i tërësishëm, përpos që krijoi mundësinë e depërtimit të rërës dhe zhavorrit nga vendet përreth, tek disa u bë atraktive që të provonin të merreshin me këtë veprimtari ilegale, ku nuk përjashtohet mundësia e veprimit të tyre, sidomos gjatë natës dhe pas përfundimit të orarit të punës”, thotë këshilltari Qehaja.

“Të themi të drejtën vendimi më herët ka qenë i mirë por nuk ka prodhuar efekt sepse resursi është i nevojshëm për ekonominë e tregut dhe nuk ka ndonjë arsye që ky resurs të pezullohet apo mos të merret fare”, thotë kryespektori Gashi.

DRINI “PRONË” E ILEGALËVE

Drini i Bardhë është lumi më i madh në Kosovë, me gjatësi 122 kilometra. Disa pjesë të këtij lumi për vite me radhë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë në duar të eksploatuesve ilegalë të rërës dhe zhavorrit.

Preportr ka dalë në terren dhe ka parë se si edhe pas marrjes së vendimeve nga qeveria që t’i ruajë lumenjtë nga këta eksploatues, ata ende janë në duart e tyre. Në fshatin Kramovik, vend ky ku lumi është dëmtuar më së shumeti, shihet që makineritë eksploatuese kanë hapur gropa të reja në kërkim të rërës dhe zhavorrit. Gjendja duket shumë e keqe dhe vendi me plot gropa që janë mbushur me ujë ka mbetur në atë gjendje, duke paraqitur rrezik edhe për jetën e banorëve që jetojnë përreth.

Për degradimin e këtij lumi në këtë masë janë shkruar raporte, janë dhënë edhe shifra se në ç’masë është dëmtuar, por pak veprime janë ndërmarrë në parandalimin e degradimit të mëtejshëm të këtij lumi.

Preportr ka vizituar edhe pika të tjera në lumenj të tjerë në Rrafshin e Dukagjinit, ku ka vërejtur se ata janë dëmtuar shumë nga ndërhyrjet që i kanë bërë kompanitë.

Një pikë e tillë është edhe në Lumbardhin e Pejës, ku shihet se kompanitë kanë ndikuar që përmes ndërhyrjeve të tyre ta ndërrojnë rrjedhën natyrale të ujit. E njëjta gjë vërehet edhe në lumenjtë e tjerë dhe kjo në të ardhmen mund të paraqesë rrezik për përmytje të mëdha – gjë që ka ndodhur disa herë viteve të fundit.

Shënim: “Ky botim është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Vërejtje: “Ky botim është realizuar me përkrahjen nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”. Përmbytja e këtij botimi është përgjegjësi e ÇOHU dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së apo KCSF-së